

NATA E BARDHË

Tirana zgjuar nga ora 18:00 deri në mesnatë!

KU TË SHKOJ?


- Ekspozitë?
- Opera?
- Film?

“Nata e Bardhë”, koncept i një përpjekjeje për të sjellë artin pranë njerëzve në hapësirat publike, një ngjarje që ndodh në dhjetë orë, me një qëllim për të krijuar art të kup-tueshëm për audiencë të madhe, duke frymëzur dialogun dhe angazhimin e publikut për të kup-

tur rëndësinë e saj dhe duke ndjerë ndikimin në hapësirën publike. Një ngjarje e lirë që inkurajon festimin dhe angazhimin e komunitetit

Për një natë, hapësirat e qytetit do të shndërrohen në ekspozita të përkohshme Arti .

29 Nëntori një natë e gjatë, ku qyteti dhe institucionet e artit do të gjallojnë me aktivitetet e artit, shfaqjet, instalacionet, filmat duke e kthyer “Natën e Bardhë” shqiptare një event kulturor që e afron Tiranën me shumë qytete evropiane



EKSPOZITA DHE HISTORI



Në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar do të hapet ekspozita me temë: “104-vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë”, e cila zhvillohet si bashkëpunim i Muzeut Historik Kombëtar me Qendrën Mbarëkombëtare të Koleksionistëve Shqiptarë. Në ekspozitë prezantohen: Pena historike e firmosjes së Aktit të Pavarësisë së Shqipërisë, flamuj kombëtarë, bustet e disa prej anëtarëve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, vula të administratës së kohës, periodikë, materiale etnografike me simbole kombëtare, fotografi origjinale të kohës, libra të kohës etj.

Në Sallën UNESCO do të transmetohen gjatë ditës filma shqiptarë, me hyrje të lirë për të interesuarit.

Nata e Bardhë hap dyert edhe për Mozaikun e Tiranës, i cili do të jetë i hapur për vizitorët.

SKËNDERBEU NË OPERA



Në skenën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit do mund të ndiqni një nga krijimet më të bukura shqiptare, opera-n “Skënderbeu” të Prenk Jakovës, interpretuar nga artistët lirikë të TKOB, ora 19:00

EKSPOZITA DHE NGJYRA

GKA do të prezantojë dy skulptura të artistit bashkëkohor Eltjon Valle, i ftuar nga GKA.



Në këtë kuadër do të organizohet konferenca për mediat në orën 12.00 të datës 29 nëntor, ku do të jetë e pranishme edhe kuratorja italiane Angela Madesani.

Publiku do të ketë mundësinë të vizitojë sallat e GKA me vepra të autorëve të traditës, të realizmit socialist, si dhe pavijonin e ri me vizatime të artistëve shqiptarë.



GKA do të jetë e hapur për publikun nga ora 18.00 – 02:00

SKENAT PËR FËMIJË

Ekspozitë me punimet e fëmijëve në formën e një instalacioni e cila do të jetë në Hollin e Teatrit,
ora 09:00 – 21:00

Shfaqje me kukulla nga trupa e Teatrit të Kukullave ;
ora 10:30 – 11:00

Koncert festiv me fëmijët e qendrës kombëtare të kulturës për fëmijë:
ora 11:00 – 12:30.

Shfaqja e filmave vizatimor për fëmijë nga Kinema-ja Shqiptare; ora 12:30 - 18:00



Shfaqja Muzikale për fëmijë “Rozi dhe Kopshti magjik”; ora 18:00 - 19:00



“Nostalgjia e filmit për fëmijë : “Qyteti më i bukur në botë”, “Mimoza Llastica”, “Një vonesë e vogël”.

FILMAT SHQIPTARE NË CINEPLEX

Në kinematë Cineplex, TEG, Tiranë, përgjatë gjithë orareve të datave 28 dhe 29 Nëntor 2016, në vlerën e biletës 200 Lek mund të shihni filmat shqiptarë .

E hënë, 28 nëntor:

“Tomka dhe shokët e tij” ora 13:45

“Pritja” ora 14:30

“Gjoleka Djali i Abazit” ora 15:45

“Anija” ora 17:45

“Nëntori i Dytë” ora 20:00



E martë, 29 nëntor:

“Lindje Perëndim Lindje” ora 13:30

“Amsterdam Express” ora 15:45

“I Dashur Armik” ora 17:45

“Trishtimi i Zonjës Shnajder” ora 20:00

“Bota” ora 22:00



CIRKU KOMBWTAR, PANTOMIM Ë DHE ILUSIONE



Në Arenën e Cirkut Kombëtar, do të shfaqet premiera e re për fëmijë e titulluar “Flintstones”;

Ora 11:00 -12: 00

50 artistë, akrobatë dhe kërcimtarë të të gjitha moshave. në shëtitoren pranë Galerisë Kombëtare do të realizohet një spektakël i plotë, ku do të luajnë të alternuar si artistë profesionistë, artistët vegjël të Studios së Cirkut Kombëtar si dhe artistët amatorë. Pjesë e aktivitetit do të jetë edhe grupi i valleve popullore “Trad Folk Tirana”. Mund të ndiqni numra akrobatikë, ekuilibri, zhonglerimi, pantomima, numra iluzionit, numra me kafshë, kërcime etj. Ora 12: 30 – 13:30